



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 136/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Nevzad Hydaverdi, për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar për anëtarë të Kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Kosova Tyrk Birlige (KTB), për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si i palejueshëm apeli i Nevzad Hydaverdi, kandidat për anëtar të Kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Kosova Tyrk Birlige (KTB).

### Arsyetim

Me datën 02.10.2013 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Nevzad Hydaverdi, kandidat për anëtar të Kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik KTB me të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për anëtar të kuvendit komunal në Prishtinë. Parashtruesi i apelit thekson se ai është anëtar i Komisionit të Pavarur për Media dhe se kandidimi i tij si kandidat për anëtar të kuvendit komunal është në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 3 pika 3.7 të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media. Më tutje parashtruesi i apelit thekson se ai nuk ka asnjë post udhëheqës në këtë parti dhe se nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet politik si dhe nuk ka planifikuar që të bëjë fushatë zgjedhore.

Në njoftimin e subjektit politik KTB të dërguar ne PZAP me dt. 02.10.2013, theksohet se duke e respektuar të drejtën e pa mohueshme të kandidatit Nevzad Hydaverdi për tërheqje nga gara zgjedhore, kryesia e subjektit politik KTB një zëri ka aprovuar vendimin e tij për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar, me vendimin e tillë nëpërmes një shkrese zyrtare është informuar edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që kandidatit i lartpërmendura tërhiqet nga gara zgjedhor për anëtarë të kuvendit komunal në komunën e Prishtinës.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e këtij apeli dhe gjeti se:

**apeli është i palejuar**

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve të certifikuar nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Meqenëse pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

A nr. 136/2013 më datën 03.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*